



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1063/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kica anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Ibish Berisha, votues nga Prishtina, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1063/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga Ibish Berisha, votues nga Prishtina, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021, nga Ibish Berisha, votues nga Prishtina, me të cilën pretendon se në vendvotimet 1911E/02, Shkollë "Ismail Qemajli" ka votuar me familjarët e tij për subjektin Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kandidatin me numër 13, dhe se votat e tyre nuk gjenden në Formularët e Rezultateve për Kandidat-FRK, pas shpalljes së rezultateve nga KQZ.

Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë, si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për pasqyrim jo të drejtë të rezultateve edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli nuk mund të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të parashtruesit të apelit dhe familjarëve të tij, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i Ibish Berisha, votues nga Prishtina, nuk është bazuar në asnjë dëshmi bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit apo regjistrimit të votave për subjekt politik apo kandidat, dhe si i tillë apeli vlerësohet si i pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli parashtruar nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1063/2021 më datën 07.11.2021



Kryesues i Panelit

Burim Ademi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.